



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.80

Prishtinë, më 28.05.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Bekë Berisha, kryetar i Komisionit Enver Dugolli- nënkryetar i parë, Erxhan Galushi - nënkryetar i dytë, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, , Dimal Basha, anëtar.

Mungoi: Rashit Qalaj, Anton Quni, Hisen Berisha -anëtar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Faton Krasniqi- ndërlidhës legjislativ mes Kuvendit dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Besnik Fetahu (Grupi parlamentar i VV), Laurenta Zogaj-Asistente në Komisionin Parlamentar

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku (koordinator), Zarë Aliu (zyrtare e lartë)

Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur me datë 30.04.2024;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-267 për Letërnjoftimin;
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për projektligjin Nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë;
6. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri;
7. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamentet për Projektligjin Nr.08/L-286 për Shtetësinë e Kosovës;

8. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamentet për Projektligjin Nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës;
9. Të ndryshme.

Në vijim të mbledhjes u kalua në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

Mefail Bajqinovci, i nderuar Kryetar, duke qenë se kanë qenë disa dilema nga anëtarët e Komisionit për Projektligjin Nr.08/L-286 për Shtetësinë e Kosovës, si kryesues i grupit punues për këtë projektligj, propozoi që të hiqet nga rendi i ditës dhe në një nga mbledhjet e radhës të shqyrtohet, në mënyrë që të jenë edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari, duke qenë se është kjo kërkesë, atëherë e miratojmë rendin e ditës me ndryshime, ku pika shtatë e rendit të ditës hiqet. A jeni për?

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur me datë 30.04.2024.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Kryetari, të nderuar anëtar të Komisionit, kemi pranuar rekomandimet nga Komisionet e përhershme për këtë Projektligj, nuk ka ndonjë rekomandim. Andaj propozoj që ta hedhim në votim dhe të procedojmë për lexim të dytë në seancë plenare. Nëse e donë dikush fjalën para se ta hedhim në votim, urdhëroni.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me gjashtë vota për dhe një abstenim nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe procedohet për seancë për lexim të dytë.

4. Shqyrtimi i raporti me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-267 për Letërnjoftimin.

Kryetari, edhe për këtë Projektligj kemi pranuar rekomandimet nga Komisionet e përhershme, nuk ka ndonjë vërejtje, andaj propozoj që ta hedhim në votim dhe të procedojmë për lexim të dytë në seancë plenare. A jeni për?

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-267 për Letërnjoftimin dhe procedohet për seancë për lexim të dytë.

5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për projektligjin Nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë.

Kryetari, gjithashtu edhe për këtë Projektligj kemi pranuar rekomandimet nga Komisionet e përhershme, andaj propozoj që ta hedhim në votim dhe të procedojmë për lexim të dytë në seancë plenare. A jeni për?

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me rekomandime për projektligjin Nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe procedohet për seancë për lexim të dytë.

6. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri.

Kryetari, edhe për Projektligjin për Mbrojtje nga Zjarri kemi pranuar rekomandimet nga Komisionet e përhershme, andaj propozoj miratimin dhe procedimin për lexim të dytë në seancë plenare. A jeni për?

Komisioni për Çështjet e sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri dhe procedohet për seancë për lexim të dytë.

7. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamentet për Projektligjin Nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, gjithashtu edhe për këtë Projektligj grupi punues ka përfunduar punën e tyre dhe sot i prezanton amendamente. Fjalën ia kaloi znj. Shqipe Mehmeti Selimi, për të prezantuar raportin, si kryesuese e grupit punues për këtë Projektligj dhe më pas votohet raporti dhe procedohet tek komisionet e përhershme të Kuvendit.

Shqipe Mehmeti Selimi, në cilësinë e kryesueses së grupit punues, theksoi se kanë punuar në grupin punues, disa amendamente të propozuara nga z. Rashit Qalaj janë marrë parasysh dhe janë përfshirë si rekomandime të Komisionit. Amendamentet e propozuar janë ato që janë propozuar dhe ftoi anëtarët e Komisionit që të votojnë.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës miratohet dhe dërgohet tek komisionet e përhershme të Kuvendit për vlerësim sipas fushëveprimit të tyre.

8. Të ndryshme.

Kryetari, a ka dikush diçka për të shtuar në këtë pikë?

Dimal Basha, duke iu referuar planit të punës, theksoi se janë bërë disa planifikime për vizita në terren dhe ende asnjë vizitë nuk është realizuar. Propozoi që të planifikohen disa vizita në terren.

Shqip Mehmeti Selimi, propozoi që të realizohet një vizitë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë.

Dimal Basha, propozoi që edhe në qendrat e regjistrimit të realizohen vizita nga ana e Komisionit.

Kryetari, propozoi që të realizohet një vizitë punë edhe në Stacionin Policor në Pejë. Gjithashtu propozoi edhe organizimin e një dreke pune me pjesëtarët e policisë në Pejë, pas realizimit të vizitës.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Pas përfundimit të vizitës në stacionin Policor në Pejë, Komisioni shtron drekë pune. Vizita planifikohet me datë 11 qershor 2024.

Kryetari, njoftoi për ftesën e pranuar nga RACVIAC për takimin rajonal të Komisioneve të Sigurisë dhe Mbrojtjes, që do të mbahet në Sarajevë 11-13 qershor. Propozoi z. Erxhan Galushi për

të marrë pjesë në këtë konferencë rajonale. Gjithashtu edhe deputeti Arbër Rexha u propozua që të jetë në këtë vizitë.

Gjithashtu njoftoi për vizitën e ish-Komisionerit Reinhold Robbe në Kosovë, i cili ka kërkuar një takim me Komisionin, andaj ftoj që të jeni prezent në këtë takim në javën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Bekë Berisha,
Kryetar i Komisionit
